



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

GRUAJA NË FOKUS

Gazetë e ilustruar, Nr. 4, Prizren, 2014





Mybexhel Zhuri, Koordinatore e NJDNJ dhe Zyrtare për Barazi Gjinore, Kuvendi Komunal, Prizren



Kumrije Krasniqi, Zyrtare e Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, Prizren



Šehida Miftari, Qendra Rajonale e OSBE-së, Prizren



Nga e majta në të djathtë: Miradije Buqaj, Yllaka Berisha /Shoqata Ndërkomunale e të Verbërve dhe Atyre me të Pamë të Dobësuar/ dhe Arsim Shpejti /Kuvendi Komunal/, Prizren



Drita Krasniqi, OJQ "Iniciativa 6" dhe Grupi i Grave "Oaza", Prizren



Alida Miftari, Shoqata e Zejtarëve dhe Afaristëve, Prizren



Qëndisje, Prizren

PËRMBAJTJA:

- 3 Editorial
- 4-5 Aktivitetet e Shoqatës Ndërkomunale të Verbërve dhe Atyre me të Pamë të Dobësuar
- 6-7 Intervista e Gazetës
- 8-9 Mybexhel Zhuri, Aktivitetet e Njësisë për të Drejtat e Njeriut dhe Zyres për Barazi Gjinore pranë Kuvendit Komunal, Prizren
- 10-11 Šehida Miftari, Fuqizimi i grave kontribuon në zhvillimin më të mirë të shoqërisë
- 12-13 Grupet Joformale të Grave të Kosovës
- 14 Lajme Info
- 15-18 Ilustrime
- 19 Drita Vukshinaj, Aktivitetet e OJQ “Femra për Femrat me Aftësi të Kufizuara”, Prizren
- 20-21 Nuhi Koçinaj, Rëndësia e zhvillimit të strehimit familjar prioritet për Qendrën Për Punë Sociale në Prizren
- 22-23 Shpresa Siqeca, Shtëpia e Shejh Hasanit, Prizren & Dasma tradicionale prizrenase
- 24 Antigona Shestan & Resmija Rahmani, Aktivitetet e Organizates së Personave me Distrofi Muskulare /OPDMK/-Qendra Prizren
- 25 Lajme Info: Aktivitetet gjatë muajit Tetor muaji i mundësive të barabarta
- 26-27 Shpresa Uka, Radio emisioni kushtuar muajit Tetor muajit të luftës kundër kancerit të gjirit
- 28 Muaji Tetor - muaji i luftës kundër kancerit të gjirit
- 29 Fushata Mbarëbotërore kundër dhunës ndaj gruas
- 30 Model i endur në vek

GRUAJA NË FOKUS

Gazetë e ilustruar
Nr. 4, Prizren, 2014

EDITORIAL

Gazeta “Gruaja në Fokus” promovon barazinë gjinore në sferat e ndryshme shoqërore. Deri më tani u botuan 3 numra të kësaj gazete.

Numri 4 i Gazetës “Gruaja në Fokus” ofron informacione për aktivitetet e Zyres për Barazi Gjinore pranë Kuvendit Komunal të Prizrenit dhe aktivitetet e një Organizate të huaj që ndihmon OJQ-të dhe Kuvendin Komunal të Prizrenit. Gazeta ofron informacione për një Organizatë Qeveritare dhe disa Organizata Joqeveritare të qytetit.

Rubrikat: Editorial, Intervista e Gazetës, Aktivitetet e disa OJQ-ve të Prizrenit, Lajme Info, Ilustrime, Radio emisionet. “Gruaja në Fokus” vazhdon të fokusohet në aktivitetet e OJQ-ve të Personave me Aftësi të Kufizuara dhe të Grupit Joformal të Grave të Prizrenit. Disa artikuj i dedikohen muajit Tetor - muaji i mundësive të barabarta dhe muaji i luftës kundër kancerit të gjirit. Artikujt tjerë i dedikohen muajve Nëntor dhe Dhjetor - Fushatës mbarëbotërore kundër dhunës ndaj grave dhe fëmijëve. Vazhdojnë Rubrikat për trashëgiminë vernakulare të qytetit, trashëgiminë shpirtërore, ekspozitat dhe modelet të endura në vek që besojmë sjellin laryshi dhe e begatojnë Gazetën.

**Botimi i Gazetës
u mundësua nga
Zyra Për Barazi Gjinore
pranë Kuvendit Komunal
Prizren**

Implementues i Projektit: OJQ “Shtjefën Gjeçovi”- Prizren; **Kryeredaktor:** Shpresa Siqeca; **Bashkëpunuan:** Shoqata Ndërkomunale e të Verbërve dhe Atyre me të Pamë të Dobësuar; Grupet Joformale të Grave të Kosovës, OJQ “Handikos”-Qendra e Rehabilitimit e Bazuar në Bashkësi ; **Autorët e shkrimeve:** Mybexhel Zhuri, Šehida Miftari, Drita Vukshinaj, Nuhi Koçinaj, Shpresa Siqeca, Antigona Shestan & Resmija Rahmani, Shpresa Uka; **Shtypi:** PG “ERDI”-Prizren

AKTIVITETET E SHOQATËS NDËRKOMUNALE TË VERBËRVE DHE ATYRE ME TË PAMË TË DOBËSUAR

TRAINIMI “SHKRIM-LEXIM BRAILLE”

Në muajin Mars është organizuar trainimi “Shkrim-lexim Braille” i cili u mundësua nga Shoqata e të Verbërve dhe me të Pamë të Dobësuar të Republikës së Kosovës /SHVPDK/ ndërsa u financua nga DVV International. Në Trainim i cili zgjati 3 muaj morën pjesë 8 persona të verbër nga Prizreni dhe rajoni i tij. Njëri prej tyre do të merr pjesë në garën në Shkrim-lexim Braille e cila do ta mbahet në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës. Pritet që Trainimi të vazhdoj për një afat të pacaktuar.

Në muajin Prill është organizuar trainimi “Teknologjia Informativë” i cili është mundësuar nga SHVPDK dhe financiar nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale. Në Trainim i cili zgjati 3 muaj, gjithashtu morën pjesë 8 persona të verbër.



Zef Dani

RREGULLIMI I INFRASTRUKTURËS SË SHOQATËS

Kemi bërë kërkesa të shumta Institucioneve të ndryshme për renovimin e objektit të Shoqatës dhe ndërrimin e inventarit, pasi që ishte shumë i dëmtuar. Më në fund hasëm në mirëkuptimin e KFORIT turk që shprehën vullnet dhe dëshirë që të kryejnë renovimin e objektit dhe t'a pajisin atë me inventar të ri.

Me datën 10.V.2013 u bë hapja solemne e objektit, ku na nderoi me pjesëmarrje Nënkryetari i Kuvendit Komunal të Prizrenit, z. Ruxhdi Rexha. Shoqata Ndërkomunale e të Verbërve dhe Atyre me të Pamë të Dobësuar e falenderon shumë KFORIN turk për investimin e bërë në Shoqatë.

AKTIVITETET SPORTIVE

Ekipi i Gollballit i Shoqatës së Verbërve dhe Atyre me të Pamë të Dobësuar mori pjesë në Kampionatin e VII-të të Gollballit, i cili organizohet çdo vjet nga Federata e Sporteve për të Verbër.

Disa anëtare të Shoqatës morën pjesë në Miniolimpiadën e Personave me Aftësi të Kufizuara e cila u organizua, ashtu si viteve të tjera në Vushtrri. Në të njëjtën ditë u zhvillua edhe loja e Gollballit, ku pjesëmarrësit e Shoqatës u dekoruan me vendin e tretë.

AKTIVITETET E SHOQATËS NDËRKOMUNALE TË VERBËRVE DHE ATYRE ME TË PAMË TË DOBËSUAR

BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT QEVERTARE DHE JOQEVERTARE

Shoqata Ndërkomunale e të Verbërve dhe Atyre me të Pamë të Dobësuar /SHVPDK/ bashkëpunon me Shoqatën e të Verbërve dhe Atyre me të Pamë të Dobësuar të Republikës së Kosovës dhe me të gjitha OJQ-të e Prizrenit, sidomos me OJQ-të me Aftësi të Kufizuara. Ajo gjithashtu bashkëpunon me Kuvendin Komunal të Prizrenit - Zyren e NJDNJ dhe të Barazisë Gjinore, si dhe me Qendrën për Punë Sociale.

SHVPDK bashkëpunon me Organizata të huaja, sidomos me KFORIN turk, Qendrën Rajonale të OSBE-së në Prizren etj.



*Myrvete Xhezairi
me përcjellësen Donjeta Krasniqi*

MUAJI TETOR

MUAJI I MUNDËSIVE TË BARABARTA

Gjatë muajit Tetor, muaji i mundësive të barabarta, Shoqata, bashkë me Shoqatën e Gjakovës, organizuan në Gjakovë manifestimin “Java e Shkopit të Bardhë.”

Gjatë muajit Tetor, 4 anëtarë të SHVPDK u punësuan në disa Organizata qeveritare dhe ndërrmarje private: Valmira Berisha /Kuvendi Komunal/, Alberije Krasniqi /Agjensioni Turistik “Veseli-turs”/, Yllka Berisha /Spitali Rajonal/ dhe Elsim Murati /Qendra tregtare “Ben-af.”/

Gjatë muajit Tetor, 4 anëtarë të SHVPDK morën pjesë në Radio emisione kushtuar Muajit të mundësive të barabarta: Miradije Buçaj, Valmira Berisha, Elsim Murati dhe Yllka Berisha.



Valon Abdurahmani

**INTERVISTA E GAZETËS
BISEDË ME Z. VJOSA SMAJLAJ,
PROFESORESHË NË GJIMNAZIN “GJON BUZUKU”, PRIZREN**

Pyetjet e parashtruara nga OJQ - të e qytetit



VJOSA SMAJLAJ

A mendoni se gratë që mirren me biznese private duhet të lirohen nga tatimi?:

Mendoj se nuk duhet të lirohen, sepse pastaj burrat i regjistrojnë bizneset e tyre në emër të grave. Unë kam propozuar Grupit të Grave Asambleiste që të ketë përjashtime për gratë vetëushqyese dhe kryefamiljare. Por ky propozim akoma nuk është parashtruar në Asamblenë Komunale.

Çka kanë bërë femrat Asambleiste të Kuvendit Komunal të Prizrenit për çështjen gjinore gjatë votimit të buxhetit për vitet 2012-2013?

Në vitin 2012 ato kanë kërkuar që në buxhet të përfshihen 100.000 E. të cilat do të përdoren për Projektet e Organizatave Joqeveritare të grave, përmes Njesisë për të Drejtat e Njeriut dhe Zyres për Barazi Gjinore. Kjo kërkesë është aprovuar në Kuvendin Komunal të Prizrenit.

Në Komitetin për Politika e Financa nuk kemi femra, sepse ato nuk kanë

pasë përkrahjen e dy partive më të mëdha politike të qytetit.

A duhet të ketë një Zyre në Prizren për konsultime në mes të Asambleistëve të Kuvendit Komunal dhe të OJQ-ve të qytetit?

Para 3 vitesh, Asambleistet e Kuvendit Komunal të Prizrenit kanë kërkuar një Zyre për konsultime në mes të Asambleistëve dhe të OJQ-ve të qytetit. Mirëpo kjo kërkesë nuk është aprovuar.

Sa bashkëpunoni me Zyren për Barazi Gjinore dhe Grupin Joformal të Grave të Prizrenit?

Ndonjëherë marrë pjesë në mbledhjet që Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Zyra për Barazi Gjinore organizon me OJQ-të e qytetit. Kam marrë pjesë në Takimet e Grupit Joformal të Grave të Prizrenit në Gjilan, Krushë të Madhe, Radavc etj.

Nëse Grupi Joformal i Grave të Prizrenit kërkon nga Kuvendi Komunal 5000 E. për participim në blerjen e mamografisë mobile, a kishit me e përkrahë këtë iniciativë?

Natyrisht se po. Pasi që kërkesa parashtrohet në Planin e Buxhetimit gjinor për vitin 2013, mjetet mund të realizohen përmes Departamentit të Shëndetësisë pranë Kuvendit Komunal të Prizrenit.

INTERVISTA E GAZETËS
BISEDË ME Z. ARDITA IBRAHIMI, PROFESORESHË NË
GJIMNAZIN “GJON BUZUKU”, PRIZREN

Pyetjet e parashtruara nga OJQ - të e qytetit

OJQ “Femra për Femrat me Aftësi të Kufizuara”, Prizren

Nëse OJQ-të që mirren me aftësi të kufizuara dorëzojnë një Plan Strategjik në Asamblenë Komunale që çështja e aftësisë së kufizuar të hyj në politkat lokale, a do të gjejnë përkrahjen e juaj?

Natyrisht se i përkrahim, sepse është në dobi të personave me aftësi të kufizuara por edhe në dobi të tërë shoqërisë.

OJQ për hulumtime etnologjike dhe folklorike “Shtjefën Gjeçovi” Prizren

A mendoni se Prizreni duhet të ketë një Qendër ku gratë mundë të shesin prodhimet e tyre?

Mendoj se një Qendër e tillë është më se e nevojshme që të funksionoj gjatë sezonit turistik veror. Kjo Qendër duhet të shfrytëzohet në mënyrë të organizuar nga OJQ-të që mirren me artizanate. Secila OJQ për një afat të caktuar kohor, p.sh. një muaj merr përsipër organizimin e ekspozitave shitëse ose të Panairëve të artizanateve. Shembuj të ngjashëm ka në Turqi, Kroaci dhe shumë vende të tjera. Gjithashtu Prizreni ka nevojë për një Qendër ku të gjitha OJQ-të do të mblidhen dhe komunikimi mes tyre e qytetarëve do të jetë më i afërt.

Grupi Joformal i Grave pranë Qendrës Rajonale të OSBE-së, Prizren

Cilat janë arësyet e përfaqësimit të ulët të grave në sektorin e biznesit?



ARDITA IBRAHIMI

Në Prizren dhe në rajonin e tij, numri i grave në biznes është i vogël. Shumica e femrave nuk kanë kushte ekonomike dhe nuk mund të marrin kredi për me fillue një biznes. Mentaliteti, mungesa e vetëbesimit, obligimet e mëdha familjare, mungesa e guximit si dhe taksat e larta gjithashtu janë pengesa evidente. Mungon përkrahja institucionale ndaj femrave në biznes, sepse nuk ua lehtësojnë atyre pagesat e tatimeve. Në Asamblenë Komunale kemi kërkuar që femra në biznes të mos paguaj tatim dy vitet e para.

Për kyqjen e numrit më të madh të femrave në biznes, sëpari duhet të bëhet identifikimi i femrave që mirren me aktivitete që mund të shndërrohen në biznes, gjetja e tregut, organizimi i trainimeve dhe kurseve në degët e bujqësisë, floktarisë, rrobaqepësisë, artizanateve etj.

Rritja e grave në biznes do të ndikoj në zbutjen e papunësisë dhe në pavarësinë e tyre ekonomike. Hapja e bizneseve do të motivoj gra të tjera të hapin bizneset e tyre fitimprurëse për veten dhe familjen.

AKTIVITETET E E NJËSISË PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE ZYRES PËR BARAZI GJINORE PRANË KUVENDIT KOMUNAL-PRIZREN

Mybexhel Zhuri

NJËSIA PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE ZYRA PËR BARAZI GJINORE PRANË KUVENDIT KOMUNAL PRIZREN

Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut /NJDNJ/ dhe Zyra për Barazi Gjinore është mekanizëm komunal për promovimin dhe mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në komunën e Prizrenit. Shërben si monitoruese dhe këshillëdhënëse për zbatimin e legjislacionit vendor dhe të gjitha dokumenteve ndërkombëtare si dhe të standardeve për të Drejtat e Njeriut.

NJDNJ në këtë periudhë kryesisht është fokusuar në realizimin e objektivave që dalin nga Plani i Veprimit për Barazi Gjinore të komunës së Prizrenit për periudhën 2012-2014, i cili është aprovuar nga Asambleja komunale.

Përkushtimi i Kuvendit Komunal dhe serioziteti në këtë fushë dëshkohet përmes përkrahjes dhe kontributit të konsiderueshëm për realizimin e projekteve të ndryshme.

PËRKRAHJA NË LOGJISTIKË

Komuna në vazhdimsi ka ofruar dhe ofron përkrahje në logjistikë - në dhënjën e objekteve dhe të lokaleve komunale në shfrytëzim OJQ-ve komunale, për zhvillimin e aktiviteteve të tyre. Këtë vjet ajo ka ofruar përkrahje Qendrës për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve, Shoqatës së Shurdhërve, OJQ-së K.B.K. "Marsi"/Klubi i Basketit në Karroca/, OJQ-së "Handikos"-Qendra e Rehabilitimit e Bazuar në Bashkësi, Qendrës Burimore për Fëmijët /Personat/ me sindromën Down /DKS/ - Qendra Prizren, Shoqatës së Grave "Teuta" etj.

Komuna ka mbështetë me lokal OJQ-në e grave "Femra për Femrat me Aftësi të

Kufizuara" në Qendrën për Kulturë dhe Zhvillim "Europa". Këtu punohen, ekspozohen dhe shiten punimet e rreth 50 personave me aftësi të kufizuara.

Në Qendrën "Europa" është përkrahur biznesi i një gruaje e cila merret me punime delikate të dorës dhe ka të punësuar 8 femra.

Komuna jep në shfrytëzim sallat e mbledhjeve për realizimin e takimeve, fushatave, tryezave si dhe siguron transport për çdo aktivitet të organizuar nga ana e grupeve të ndryshme të shoqërisë civile.

DONACIONE PËR OJQ-të

Përkrahjet financiare të fushatave, projekteve të ndryshme komunale dhe projekteve të OJQ-ve bëhen në vazhdimsi për çdo OJQ që dëshkohet me seriozitetin e punës së vet.

Në vitin 2013 janë përkrahur projektet e këtyre OJQ-ve: OJQ e komunitetit boshnjak "Ključ" për ekpozitën e punimeve të dorës, OJQ "Femra për Femrat me Aftësi të Kufizuara" për realizimin e punimeve të dorës, Shoqata e të Shurdhërve për interpretimin e gjuhës së shenjave; Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve për pagesën e komunalieve, Shoqata e të Verbërve, OJQ për hulumtime etnologjioke dhe folklorike "Shtjefën Gjeçovi", Projekti për nder të 1 Qershorit-Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve dhe OJQ "Gruaja bashkëkohore".

MUAJI TETOR-MUAJI I MUNDËSIVE TË BARABARTA

Gjatë muajit Tetor-muaji i mundësive të barabarta është realizuar punësimi i përkohshëm dyjavor i pesë personave me aftësi të kufizuara. Ata janë punësuar në Drejtori të ndryshme pranë Kuvendit Komunal.

AKTIVITETET E E NJËSISË PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE ZYRES PËR BARAZI GJINORE PRANË KUVENDIT KOMUNAL-PRIZREN

FUSHATA KUNDËR KANCERIT TË GJIRIT

Gjatë muajve Tetor dhe Nëntor 2013, janë realizuar fushata kundër kancerit të gjirit. Janë mbajtur 5 ligjerata dhe debate dhe dy Radio-emisione /një në Radio-Helix dhe një në Radio-Prizren/. Ligjeratat i mbajti Dr. Shpresa Llukaj-Goçaj, Specialiste e Radiologjisë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, Prizren. Ligjeratat u mbajtën në Reçan, Manastiricë, Romajë, Gjonaj të Lartë dhe Gjonaj të Poshtëm. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, Prizren /QKMF/, muajin Tetor dhe Nëntor i shpalli muaj për vizita falas. Fushatat dëshmojnë se numri i vizitave mjekësore është rritur. Rreth 600 femra janë vizituar falas me ultrazë dhe mamografi.

FUSHATA KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

Gjatë muajit Nëntor dhe Dhjetor, prej 25.11.2013-10.12.2013 janë zhvilluar fushata kundër dhunës në familje. Janë mbajtur 3 ligjerata dhe debate në temën e dhunës. Prej tyre, dy ligjerata janë mbajtur me nxënës të shkollave fillore dhe të mesme dhe një ligjeratë me persona me aftësi të kufizuara. Është mbajtur një Tryezë e rrumbullakët me përfaqësues të Policisë, Gjykatës, Qendrës për Punë dhe Mirëqenie Sociale, OJQ-ve dhe personave të tjerë të rëndësishëm rreth luftimit të kësaj dukurie. Janë emituar dy Radio-emisione promovuese të të gjitha aktiviteteve gjatë fushatës kundër dhunës.

Është funksionalizuar Këshilli monitorues dhe janë kryer trainimet e anëtarëve të tij. Pritet që së shpejti Këshilli të raportoj mbi realizimin e projekteve të OJQ-ve të përkrahura nga Komuna.

PROMOVIME MEDIALE

Gjatë këtij viti, Komuna ka mbështetur disa promovime mediale. Janë mbështetur Radio-emisionet promovuese për punën dhe aktivitetet e NJDNJ dhe të OJQ-ve të qytetit. Është përkrahur botimi i dy numrave të gazetës "Gruaja në Fokus," si vazhdim i botimit nga viti i kaluar.

Këta janë tregues të mirë të përkushtimit të Komunës dhe të Kryetarit për përkrahjen e aktiviteteve komunale dhe zhvillimin e shoqërisë civile.

Janë realizuar 6 Radio-emisione në Radio-Helix dhe 2 Radio-emisione në Radio-Prizren:

1.Realizimi i Planit të Veprimit për Barazi Gjinore të Komunës së Prizrenit për periudhën 2012-2014;

2.1 Qershori-Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve;
3.Muaji Tetor-muaji i mundësive të barabarta-punësimi i personave me aftësi të kufizuara /PAK/;
4.Përmbyllja e muajit Tetor-muaji i mundësive të barabarta;
5.Fushata kundër kancerit të gjirit /Radio Helix/;
6.Përmbyllja e fushatës kundër kancerit të gjirit /Radio Prizren/;
7.Fushata kundër dhunës ndaj gruas dhe fëmijëve /Radio Helix/;
8.Përmbyllja e fushatës kundër dhunës ndaj gruas dhe fëmijëve /Radio Prizren/;

Me rastin e festave të fundvitit, fëmijët me aftësi të kufizuara nga shkollat me klasa të bashkangjitura dhe nga OJQ- të e personave me aftësi të kufizuara morën nga një dhuratë modeste.

Sa i përket realizimit të Planit të Veprimit për Barazi Gjinore të Komunës së Prizrenit për periudhën 2012-2014, janë realizuar objektivat prioritare për vitin 2013. Shpresojmë se në vitin 2014 do të realizohen objektivat të tjera të parapara.

FUQIZIMI I GRAVE KONTRIBUON NË ZHVILLIMIN MË TË MIRË TË SHOQËRISË

Šehida Miftari

Me çdo ndërrim të moteve, është praktik të vlerësohet çka është bërë, çka ka qenë e suksesshme dhe çka duhet të përmirësohet. Është koha ku njeri shikon prapa, duke u përpjekur të bashkërendoj çka është përfunduar me atë se çka na pret dhe të nxjerrë mësim.

Shikuar prapa në 2013, ne mund të shohim shumë zhvillime lidhur me fuqizimin e grave në rajonin e Prizrenit. Megjithatë progresi është i pabarabartë. Derisa disa komuna si Prizreni dhe Dragashi kanë qenë më dinamike në shtyrjen përpara të agjendës për barazi gjinore, në komuna të tjera progresi ka qenë i kufizuar. Mbase edhe hapi më i vogël ndihmon në zhvillimin e shoqërisë. Ne në Misionin e OSBE-së në Kosovë kemi vazhduar të punojmë me qeveritë lokale për të rritur vetëdijësimin lidhur me rëndësinë e vendimmarrjes gjithëpërfshirëse dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. Disa prej sukseseve të vitit 2013 të cilat vlen të përmenden janë:

SHËNIMI I DITËS NDËRKOMBËTARE TË GRAVE

Gjithë gjashtë komuna në rajon, përkatësisht Prizreni, Dragashi, Suhareka, Rahoveci, Malisheva dhe Mamusha kanë organizuar aktivitete për shënimin e kësaj dite. Aktivitetet kanë përfshirë debate me nxënës dhe

zyrtaret nga gjinia femërore lidhur me çështjet gjinore, lojë me pyetje - përgjegje (kuiz) dhe punëtori kreative ku nxënësit përgatitën dhurata simbolike për banorët e Qendrës për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve në Prizren. Këto aktivitete kanë përfshirë më shumë se 100 përfitues, përfshirë edhe nxënësit e shkollës së mesme, djem dhe vajza, burra dhe gra. Në Mamushë për shembull nënkryetarja për komunitete dhe kryesuesja e Kuvendit Komunal prezantuan përvojën e tyre si gra në administratë dhe rolin e tyre, duke shërbyer si model për nxënësit e gjinisë femërore prezentë në debat.

GRATË NDIHMOJNË GRATË

Në muajin maj OSBE-ja organizoi trainimin dy ditor për 20 gra anëtare të grupit komunal joformal të grave në rajonin e Prizrenit lidhur me menaxhimin e projektit. Ato janë ndarë në gjashtë grupe dhe janë ngarkuar me detyrë të aplikojnë shkathtësitë e fituara dhe të zhvillojnë aktivitete me ndihmën e OSBE-së. Katër prej gjashtë grupeve kanë implementuar me sukses aktivitete, të cilat përfshijnë: zhvillimin e planeve të veprimit për aktivitetet e ardhshme, vizita në terren të komuniteteve në vende rurale për t'i inkurajuar ata të shfrytëzojnë të drejtën e votës dhe punëtorinë për pikturim me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe

FUQIZIMI I GRAVE KONTRIBUON NË ZHVILLIMIN MË TË MIRË TË SHOQËRISË

prindërit e tyre.

Njohuritë e fituara duhet t'i ndihmojnë grupet komunale joformale të grave që të llobojnë për sigurimin e fondeve nga qeveritë lokale për aktivitete të tyre.

RRJETËZIMI

Qendra Rajonale e OSBE-së në Prizren ka organizuar dy vizita në terren, njerën në Gjilan dhe tjetrën në Prishtinë, me qëllim të shkëmbimit të praktikave më të mira midis grupeve komunale joformale të grave nga rajonet e ndryshme dhe për të forcuar rrjetëzimin e tyre.

Përvoja nga Gjilani në promovimin e çështjeve gjinore dhe shkëmbimi i mësimëve të përfituara me Prishtinën kanë qenë veçanërisht të dobishme për grupet komunale joformale të grave nga rajoni i Prizrenit.



VIZITA NË TERREN

E fundit por jo më pak e rëndësishme, si pjesë e fushatë ndërkombëtare kundër dhunës gjinore, OSBE-ja bashkë me grupet komunale joformale të grave nga katër komuna të rajonit dhe zyrtaret komunale për barazi gjinore (ZKBGJ) kanë takuar më shumë se 300 nxënës për t'i sensibilizuar lidhur me dhunën në familje. OSBE-ja dhe komuna e Prizrenit kanë përgatitë materialin promovues, fletushka për promovimin e jo - dhunës, si shtesë të kartolinave dhe posterëve që janë siguruar nga Gratë e Kombeve të Bashkuara) si pjesë e fushatës.

Misioni ka përkrahur dy radio debate në Prizren me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar, Zyrtares për Barazi Gjinore dhe koordinatorit për Prizren të Strehimores për viktimat e dhunës në familje. Qëllimi ishte rritja e vetëdijësimit të publikut lidhur me çështjet e diskriminimit, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe dhuna në familje.

Qendra Rajonale e OSBE-së në Prizren ka dëshirë të falënderoj të gjithëve që kanë kontribuar që viti 2013 të jetë i veçantë! Ne e mirëpresim punën me ju në drejtim të arritjes së barazisë më të mirë gjinore dhe përfaqësimit të grave në të gjithat nivelet e institucioneve.

Ne gjithashtu ju urojmë
GËZUAR VITI I RI 2014.

AKTIVITETET E GRUPEVE JOFORMALE TË GRAVE TË KOSOVËS

GRUPET JOFORMALE TË GRAVE TË KOSOVËS

Me datën 9.X.2013, Misioni i OSBE-së në Kosovë organizoi në Prishtinë ceremoninë e përmbylljes së projektit të vitit 2013 “Forcimi i kapaciteteve të Grupeve të Grave në Kuvendet Komunale të Kosovës”. Në takim ishin të ftuara Zyrtaret për barazi gjinore të Komunave të Kosovës dhe nga 1 përfaqësuese e Grupeve Joformale të Grave të Komunave ku vepron këto Grupe. Morën pjesë Grupet Joformale të Grave nga Prizreni, Dragashi, Suhareka, Gjilani, Ferizaji, Vushtrria, Mitrovica, Fushë Kosova, Gjakova, Lipjani dhe Novo Bërda. Gjatë takimit, Grupet Joformale të Grave të Kosovës, të ndara në 4 grupe, dhënë rekomandime për aktivitetet prioritare të punës së tyre për vitin 2014

I. PJESËMARRJA NË POLITIKË



1. Fuqizimi i gruas brenda subjektit politik;
2. Buxhetimi gjinor në subjektet politike;
3. Identifikimi dhe promovimi i potencialit intelektual e profesional të gruas;
4. Përfaqësimi i gruas duke marrë për bazë vlerat intelektuale dhe profesionale të saj;
5. Rritja e bashkëpunimit dhe prezencës së gruas në media;
6. Përkrahja më e madhe e gruas për gruan;
7. Pavarësimi ekonomik i gruas;
8. Arësimimi dhe guximi i gruas për me u marrë me politikë;
9. Zbatimi i ligjit për barazi gjinore dhe të Drejtat e Njeriut;
10. Pjesëmarrja e grave në zgjedhje;

II. BARAZIA GJINORE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

1. Strategjia dhe lobimi për barazi gjinore dhe të Drejtat e Njeriut të realizohen përmes Zyreve për Barazi Gjinore në Kuvendet komunale, Grupeve Joformale të Grave të Kosovës në nivel lokal dhe qendror, OJQ-ve që mirren me çështje gjinore, mediave, avokatit të popullit, Zyres për ndihma juridike falas, Zyres për ndërmjetësime etj.
2. Shoqëria civile të organizoj kampanja informative, mbledhje, fushata senzibilizuese, tryeza të rumbullakëta etj. Në këto aktivitete ku do ta marrin pjesë edhe mediat, do të shpalosen problematikat e çështjes gjinore, të cilat do të parashtrihen në Zyren për Barazi Gjinore ku do të kërkohet zgjidhja e tyre. Ndihe për realizimin e Projekteve do të kërkohen edhe nga donatorët e ndryshëm vendës dhe të jashtëm.
Të formohet një fond i veçantë për Projekte për promovimin e barazisë gjinore dhe të Drejtave të Njeriut pranë Zyres për Barazi Gjinore. Ky Fond të aprovohet në nivel qendror, nga Ministria e Financave e Kosovës.

AKTIVITETET E GRUPEVE JOFORMALE TË GRAVE TË KOSOVËS

GRUPET JOFORMALE TË GRAVE TË KOSOVËS

III.FUQIZIMI EKONOMIK I GRAVE

- 1.Ndarja e buxhetit për çështje gjinore;
 - 2.Pjesëmarrja e grave në buxhetim /planifikimin /buxhetor në nivel komunal;
 - 3.Trajtimi i barabartë i grave rreth ndarjes së pronës së përbashkët të prindërve. Ekziston Ligji për trashëgimi, por ai nuk zbatohet sa duhet nga vet gratë. Marrja e pjesës së pasurisë që u takon me ligj, do të ndikon në pavarësinë ekonomike të grave;
 - 4.Ngritja e kapaciteteve dhe stimulimi për hapjen e mikro-bizneseve të grave;
 - 5.Inkurajimi i grave në ndërmarrësi që të aplikojnë në Kuvendin Komunal për përfitimin e pronave komunale me qera të ulëta, për kryerjen e biznesit të tyre;
 - 6.Hartimi i politikave afirmative për gratë ndërmarrëse dhe përkrahja financiare nga ana institucionale për zhvillimin e bizneseve të tyre:
 - a.Formimi i fondeve të veçanta për biznese të grave;
 - b. Mospagesa e tatimit 6 muajt e para të fillimit të biznesit;
 - c.Tatimet më të ulëta;
 - d.Lehtësira në kredimarrje etj.
 - 7.Bashkëpunimi rajonal në zhvillimin e bizneseve private;
 - 8.Pjesëmarrje në panairë të ndryshme të artizanateve në nivel rajonal;
 - 9.Mosdiskriminim në politikat e punësimit dhe të shkollimit të femrave;
 - 10.Hartimi i strategjisë për persona me nevoja të veçanta, gratë kryfamiliarë, grupet sociale dhe penzionistë;
- Lobimi për realizimin e këtyre

aktiviteteve do të bëhet përmes Këshillit të lagjeve, Këshillit të fshatrave, grave anëtare të Asamblesë Komunale, Grupeve të qytetarëve etj.

IV- MËNYRA PËR NGRITJEN E BASHKËPUNIMIT NË NIVEL LOKAL DHE QENDROR

- 1.Fuqizimi dhe bashkëpunimi i Grupeve Joformale të Grave të Kosovës në nivel lokal;
- 2.Takime të rregullta të Grupeve Joformale të Grave të nivelit lokal me Grupin Joformal të Grave të nivelit qendror të organizohen çdo 3 muajt;
- 3.Formimi i Rrjetit të Grupeve Joformale të Grave në nivel lokal, i cili më lehtë do të komunikoj me Grupin Joformal të Grave të nivelit qendror;
- 4.Kërkesat e Grupeve Joformale të Grave të nivelit lokal të përkrahen nga Grupi Joformal i Grave të nivelit qendror;
- 5.Zbatimi i Ligjit për barazi gjinore, sidomos në fushën e vendimmarrjes;
- 6.Zbatimi i Ligjit të Punës, sidomos për pushimin e lehonisë dhe punësimit të personave me nevoja të veçanta.
- 7.Iniciativa të përbashkëta në mes të Grupeve Joformale të Grave të nivelit lokal dhe qendror rreth zbatimit të Ligjit të trashëgimisë pronësore familjare nga prindët te fëmijët pa diskriminime gjinore;
- 8.Grupet Joformale të Grave të Kosovës të funksionojnë me një Program /Platformë/ të përbashkët, duke iu përshtatur specifikave dhe prioritetëve të komunave;

PANAIRI I ARTIZANATEVE NË PRIZREN

Me rastin e mbajtjes së Festivalit Ndërkombëtar të Filmit Dokumentar dhe të Shkurtër “Dokufest”, në lagjen e Arastës /ish Parkingu i qytetit/, u organizua Panairi i Librit dhe i Artizanateve.

Në Panairin e Artizanateve morën pjesë: Myzafere Jelliqi, Drita Vukshinaj, kryetare e OJQ-së “Femra për Femrat me Aftësi të Kufizuara”, Shpresa Makasçiu dhe Gentiana Makasçiu, anëtare të Shoqatës së Zejtarëve dhe të Afaristëve të Prizrenit /SHZAP/ etj. Në Panair u ekspozuan dhe u shitën artizanate të punuara nga personat me aftësi të kufizuara, bizhuteri, piktura etj.

AKTIVITET E OJQ “HANDIKOS” QENDRA E REHABILITIMIT E BAZUAR NË BASHKËSI

Gjatë muajit Tetor - muaji i mundësive të barabarta, disa anëtarë të OJQ-së “Handikos” kanë marrë pjesë në manifestimin “Trainimi dhe gara në biliard për persona me aftësi të kufizuara”, të organizuar me datën 17. X.2013 në Prizren.

Gjatë muajit Tetor - muaji i mundësive të barabarta, 10 anëtarë të OJQ-së “Handikos” janë punësuar përkohësisht në këto Institucione shtetërore dhe private: Kuvendi Komunal, Drejtoria për Arësim, Qendra Rajonale e OSBE-së, Prizren, Qendra tregtare “Abi”, Qendra tregtare “Benaf” dhe disa ndërmarrje të tjera private.

Me 31.X.2013, Zijada Xhaferi, Koordinatore e femrave në OJQ “Handikos” mori pjesë në Radio emisionin kushtuar përfundimit të muajit Tetor - muaji i mundësive të barabarta. Ajo theksoi se personat me aftësi të kufizuara kanë nevojë për të punuar dhe puna më e përshtatshme është në zyre, me kompjuterë. Fiton një përvojë pune dhe shoqëria të çmon më shumë. Pavarësimi ekonomik na bën më të hapur në shoqëri. Prandaj Kuvendi Komunal si dhe të gjitha Institucionet të tjera duhet të na ndihmojnë në të ardhmen. Emisioni u mundësua nga Qendra Rajonale e OSBE-së, Prizren.

Gjatë këtij muaji, Zijada Xhaferi u punësua për 3 ditë në Qendrën Rajonale të OSBE-së, Prizren.

Me 16. IX.2013, anëtarët e OJQ-së “Handikos” të Prishtinës e vizituan Prizrenin. Në shoqëri me anëtarët e OJQ “Handikos” të Prizrenit, ata e vizituan Kompleksin Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe monumentet të tjera kulturo - historike të qytetit.

PËR NJË JETË MË TË MIRË NË SHOQËRI

Në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2013, OJQ “Gruaja bashkëkohore” Prizren, implementoi Projektin “Për një jetë më të mirë në shoqëri.” Projekti ka për qëllim të ndihmojë personat me aftësi të kufizuara, sidomos gratë, të mirren me aktivitete rekreative - sportive, ushtrime dhe terapi fizikale.

Aktivitetet u zhvilluan 5 ditë në javë dhe zgjatën tre muaj. Morën pjesë rreth 50 persona me aftësi të kufizuara të Organizatave të ndryshme Joqeveritare: Shoqata Ndërkomunale e të Verbërve dhe Atyre me të Pamë të Dobësuar, Shoqata e të Shurdhërve, Shoqata “Femra për Femrat me Aftësi të Kufizuara” etj. Gjithashtu morën pjesë personat në asistencë sociale, fëmijët e dëshmorëve etj.

Përgjegjëse e Projektit ishte Fetije Mehmeti, kryetare e OJQ-së “Gruaja bashkëkohore” Prizren.

Projekti u financua nga Kuvendi Komunal i Prizrenit - Zyra e NJDNJ dhe e Barazisë Gjinore.

PROMOVIMI I GRUPEVE JOFORMALE TË GRAVE TË DISA KOMUNAVE TË KOSOVËS

Më 16.X.2013, Misioni i OSBE-së në Kosovë organizoi një takim në Prishtinë me Zyrat për Barazi Gjinore dhe Grupet Joformale të Grave të disa komunave të Kosovës: Prishtinës, Prizrenit, Pejës, Dragashit, Graçanicës, Klinës dhe Lipjanit. Takimi u mbajtë në Kuvendin Komunal të Prishtinës-Zyren Rajonale të OSBE-së, Prishtinë. Zyrat për Barazi Gjinore dhe Grupet Joformale të Grave prezantuan aktivitetet e realizuara gjatë viteve të kaluara dhe Strategjinë e punës për vitin 2014.

Qëllimi i takimit: Shkëmbimi i përvojave në mes të Zyratave për Barazi Gjinore dhe të Grupeve Joformale të Grave dhe vazhdimi i bashkëpunimit në mes të tyre për aktivitetet e ardhshme.

Grupet Joformale të Grave të Kosovës u themeluan me ndihmën e Misionit të OSBE-së në Kosovë rreth viteve 2010-2012.



*Ceremonia e përmbylljes së Projektit
 “Forcimi i kapaciteteve të Grupeve të Grave në Kuvendet Komunale të Kosovës”
 organizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, Prishtinë 9.X.2013,*



*Promovimi i Grupeve Joformale të Grave të disa Komunave të Kosovës,
 organizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, Prishtinë 16.X.2013*



Sadete Tërnava-Osmari, Gjilan



*Rema Isufi, Grupi i Grave
 Joformale, Vushtrri*





Qendra Për Fëmijët /Personat/ me sindromën DOWN /DKS/, Qendra Prizren

Hadije Hoti, Shoqata e të Shurdhërve, Prizren



Nga e majta në të djathtë: Refik Kryeziu dhe Musli Xhoxhaj, OJQ K.B.K. "Marsi"/Klubi i Basketit në Karroca/, Prizren

Ndarja e dhuratave të Vitit të Ri fëmijëve me aftësi të kufizuara /Zyra e NJDNJ dhe e Barazisë Gjinore, Kuvendi Komunal, Prizren/



OJQ "Handikos," Qendra e Rehabilitimit e Bazuar në Bashkësi, Prizren



Nga e majta në të djathtë: Mybexhel Zhuri, Koordinatore e NJDNJ dhe Zyrtare për Barazi Gjionore, Kuvendi Komunal, Prizren dhe Jubilea Kabashi, Drejtoreshë Ekzekutive e Qendrës për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve, Prizren /Radio emisioni kushtuar dhunës në familje/.



Nga e majta në të djathtë: Suzana Gështenja, /Zyrtare e Kuvendit Komunal/, Myqerem Karaçi dhe Krenare Hajredini /Shoqata e Femrave të Shurdhër, Prizren/



Bedrije Berisha, Anëtare e Komitetit për Perona me Aftësi të Kufizuara, Prizren



Qilim, Prizren



Ekspozita e fotografive të personave me nevoja të veçanta, Organizata e Personave me Distrofi Muskulore e Kosovës /OPDMK/, Qendra në Prizren



*Vehibe Karahoda,
Qendra për Punë
Sociale, Prizren*



*Nexhat Çoçaj, Drejtor i Drejtorisë për Arsim,
Kuvendi Komunal, Prizren*



*Teuta Berisha,
Caritas-i Zviceran, Prizren*



*Arta Oseku, Qendra Për Strehimin e Grave
Dhe Fëmijëve, Prizren*



*Shpresa Uka,
OJQ "Teuta," Prizren*



*Valon Totaj, Gjykata Themelore,
Prizren*



*Nga e majta në të djathtë: Nafije Gashi
dhe Mirjeta Krasniqi, OJQ "Femra për Femrat
me Aftësi të Kufizuara", Prizren*



*Ligjerata kundër dhunës në familje,
9. XII. 2013, Prizren*

AKTIVITETET E OJQ “FEMRA PË FEMRAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA”

Drita Vukshinaj

Drita Vukshinaj Kryetare e OJQ “Femra për Femrat me Aftësi të Kufizuara” /FFAK/ mori pjesë në Panairin e Artizanateve në Prevallë /prill 2013/ si dhe në Panairin e artizanateve në Prizren /korrik dhe gusht 2013/.

Në muajin korrik, Drita Vukshinaj mori pjesë në Punëtorinë e përmbylljes së Planit strategjik për persona me aftësi të kufizuara, i cili u aprovuan në Parlamentin e Kosovës në muajin shtator.

FFAK bashkëpunon me Rrjetin e Grupit të Grave të Kosovës /RrGGK/. Drita Vukshinaj mori pjesë në Punëtorinë e RrGGK “Qëndrueshmëria e Aktivisteve”, e cila u mbajtë në Durrës, më 3-6 tetor, 2013.

Gjatë muajit Tetor - muaji i mundësive të barabarta, Drita Vukshinaj u angazhua në organizimin e punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

LISTA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA, TË PUNËSUAR GJATË MUAJIT TETOR-MUAJI I MUNDËSIVE TË BARABARTA

<i>Nr.</i>	<i>Emri dhe mbiemri</i>	<i>Organizata</i>	<i>Vendi i punësimit</i>
01	Valmira Berisha	Verbër /SHVPDK/	Kuvendi Komunal
02	Myqerem Karaçi	Femra të Shurdhër	Kuvendi Komunal
03	Fatmir Osmani	Handikos	Kuvendi Komunal
04	Drita Vukshinaj	FFAK	Kuvendi Komunal
05	Muamet Krasniqi	KBK Marsi	Kuvendi Komunal
06	Nafije Gashi	FFAK	N.P.N. Alfa-Ing Biro
07	Alberije Krasniqi	Verbër /SHVPDK/	Veseli-turs
08	Yllka Berisha	Verbër /SHVPDK/	Spital
09	Sulltane Qafleshi	Distrifi Muskulare	Spital
10	Mirjeta Krasniqi	FFAK	Spital
11	Selim Maloku	Down Syndrom	Spital
12	Sylë Kodra	KBK Marsi	Spital
13	Nafije Gashi	FFAK	ABI center
14	Musli Xhoxhaj	KBK Marsi	ABI center
15	Refki Kryeziu	KBK Marsi	ABI center
16	Resmije Rahmani	Distrifi Muskulare	Ben-af
17	Ramiz Kryeziu	Handikos	Ben-af
18	Fatime Krusha	FFAK	Ben-af
19	Elsim Murati	Verbër /SHVPDK/	Ben-af
20	Fatmir Sallah	Down Syndrom	N.P.T.SH. Limit
21	Zijada Xhaferi	Handikos	OSCE



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

RËNDËSIA E ZHVILLIMIT TË STREHIMIT FAMILJAR PRIORITET PËR QENDRËN PËR PUNË SOCIALE NË PRIZREN

Qendra për Punë Sociale në Prizren /QPS/ bashkëpunon me Amici dei Bambini e cila është një organizatë ndërkombëtare që operon në Kosovë që nga viti 1999, me motiv mbështetjen e sistemit të mbrojtjes së të miturve jashtë familjes, duke sjellë ndihma konkrete, njohuri, kompetenca dhe mjete pune nga përvoja e vet ndërkombëtare dhe duke promovuar proceset e bashkëndarjes mes vepruesve të ndryshëm të sistemit.

Tashmë, me anën e një projekti në mbështetje të Qendrave për Punë Sociale, kjo organizatë ka vënë në dispozicion psikolog të cilët i përgjigjen nevojave të qendrës në përgjithësi dhe nevojave që paraqiten për strehimin familjar në këto qendra në veçanti.

Si shumë komuna të tjera, edhe komuna e Prizrenit është tashmë pjesë e këtij projekti i cili fokusin qendror përveç mbështetjes së Qendrave për Punë Sociale ka edhe zhvillimin e strehimit familjar. Ndaj ajo që po tentohet në këtë bashkëpunim është:

- Ndërgjegjësimi i Institucioneve publike, përgjegjëse për rëndësinë e zhvillimit të strehimit familjar në nivel lokal;
- Bërja me dije e popullatës për këtë formë alternative të mbrojtjes së fëmijëve;
- Ndërgjegjësimi i popullatës për rëndësinë e strehimit familjar;
- Lobimi për fonde për zhvillimin e strehimit familjar në nivel lokal;
- Lobimi për familje strehuese;
- Krijimi i urave të bashkëpunimit dhe qëndrueshmërisë për strehimin familjar.

ÇFARË PO KËRKOHET?

Duke qenë se shumë shpejt do të vij momenti i decentralizimit të të gjitha shërbimeve sociale, edhe strehimi familjar do të jetë pjesë e këtij procesi.

Për këtë dhe shumë arsye të tjera Prizreni duhet të fillojë të mendoj seriozisht për krijimin e një numri familjesh strehuese, gjithashtu duhet të mendojë dhe të veproj në bashkëpunim me Komunën për strategji zhvillimi dhe qëndrueshmërie të kësaj forme mbrojtjeje.

PSE DUHEN FAMILJET STREHUESE?

Familjet strehuese janë ato familje të cilat paraqesin vullnetin e tyre dhe përcaktohen nga shteti sipas disa kriterëve të nevojshme për të ju ardhur në ndihmë fëmijëve pa përkujdes prindëror.

Ky shërbim është i përkohshëm për fëmijën dhe shkon aq gjatë sa të zgjidhet statusi apo të rehabilitohet gjendja në familjen origjinë.

DOMETHËNIA NË VIJA TË PËRGJITHSHME E SISTEMIT TË STREHIMIT FAMILJAR

Është një gjendje përkohshmërie. Kohëzgjatja varet nga tipi i vështirësive të pranishme në familjen e origjinës dhe kthimi i të miturit lidhet me kapërcimin e pengesave që e kanë krijuar nevojën;

Mbajtja e marrëdhënieve me familjen e origjinës nëse përcaktohet;

Parashikimi i kthimit në familjen e origjinës ose në një familje adoptuese.

RËNDËSIA E ZHVILLIMIT TË STREHIMIT FAMILJAR PRIORITET PËR QENDRËN PËR PUNË SOCIALE NË PRIZREN

Në Kosovë ekzistojnë dy tipologji strehimi: me kohë të shkurtër (6 muaj maksimumi pritje) dhe me afat të gjatë-varësisht nga specifikat esecilitrast.

Sipas Udhëzuesit Administrativ, prindi strehues mund të jetë i pamartuar, i martuar, bashkëjetues ose i ve dhe në moshë më të madhe se 25 vjet. Kur ai është prind biologjik ose birësues, i mituri më i vogël duhet të ketë mbushur 2 vjet për të mundësuar të përqendrojë energjitë e veta mbi të miturin në strehim. Kërkesa për strehuesin janë gjithashtu mungesa e detyrimeve të pazgjidhura dhe paraqitja e një vërtetimi të gjendjes gjyqësore. Familja strehuese duhet të tregojë të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe të ketë kushte të përshtatshme për pritjen e fëmijëve.

Çdo vit familjet rivlerësohen nga operatorët e shërbimeve ndërsa çdo muaj do të kryhet një vizitë në shtëpi me vlerësime të shërbimit të strehimit të zhvilluar nga çifti.

Në momentin e pritjes së një fëmije, familja strehuese nënshkruan një kontratë me Qendrën për Punë Sociale, në të cilën përcaktohen detyrimet në lidhje me fëmijën.

Për fëmijën e vendosur në strehim familjar që është në gjendje të mirë shëndetësore, Ministria ofron shumën prej 150 € në muaj ndërsa për fëmijët me nevoja të veçanta 250€ në muaj. Shumat e përmendura janë të destinuara për mbulimin e kostos së shpenzimeve të fëmijës në strehim familjar kurse familja strehuese nuk kompensohet për këtë shërbim.

KRITERET PËR FAMILJET STREHUESE

Strehuesi familjar duhet të jetë mbi moshën 25 vjeçare;

Familja strehuese duhet të ofrojë kujdes të plotë për tërë periudhën e strehimit familjar, qoftë në afat të shkurtër apo për vendosje afatgjate të fëmijës;

Fëmijët e familjes strehuese, duhet të jenë mbi moshën (2) dyvjeçare në rastet kur fëmija i strehuar është nën moshën 2 vjeçare.

Strehuesit familjar në ç'do kohë dhe moment duhet të tregojnë gatishmërinë e tyre për bashkëpunimin me prindërit natyror të fëmijës për integrimin e fëmijës në familjen e tij biologjike;

Strehuesit familjar nuk duhet të jenë të përndjekur penalisht për ndonjë vepër penale;

Strehuesit familjar në vazhdimësi duhet të jenë të gatshëm të punojnë në partneritet me Qendrat për Punë Sociale dhe shërbimet të tjera të cilat punojnë për avancimin e pozitës së fëmijëve;

Strehuesit familjar nuk duhet të jenë të punësuar në Qendra për Punë Sociale, Organizata Joqeveritare vendore ose ndërkombëtare të cilat ofrojnë shërbime të kujdesit familjar.

***Nuhi Koçinaj, Drejtor i Qendrës për
Punë Sociale***



SHTËPIA E SHEJH HASANIT, PRIZREN

Shpresa Siqeca

Shtëpia e shejh Hasanit e radhës Halveti ndodhet në qendrën urbane të qytetit, në Zonën Historike të Prizrenit. Ajo ndodhet në bregun e djathtë të lumit, përballë Urës së Gurit, në Lagjen e Farkëtarëve. Ndodhet pranë Kompleksit të teqes Halveti dhe xhamisë së Mehmed Kukli - beut/Saraçhanes/.

Shtëpia është një ndër objektet më të vjetra të arkitekturës folklorike qytetare që e ruan formën e vjetër të ndërimit. Sipas kumtimit gojor të shejh Nexhat Shehut në vitin 2000, shtëpinë e ndërtoi shejh Xhemalija.

Shtëpia i takon arkitekturës folklorike të pjesës rrafshinore të qytetit. Ajo është e ndërtuar në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Shtëpia është dykatëshe, e ndërtuar në formë simetrike, me dhoma, paradhoma dhe hajate të mëdha. Themelet dhe muret e katit përdhes janë prej gurësh. Muret janë prej konstrukti të drurit të mbushur me çerpiqë. Meskati, çatia, hatullat horizontale, dyert, dritaret dhe dyshemeja janë prej druri. Çatia është e mbuluar me tjegulla të lugëta ndërsa strehat janë të gjera. Në fillim dritaret rrethoheshin me parmakë druri, ndërsa sot ato rrethohen me parmakë druri dhe hekuri.

Në katin përdhes janë hajati me qoshkun, paradhoma e madhe, dhomat dhe banjo. Qoshku është i vogël, i hapur dhe i mbuluar me shtylla druri. Në një dhomë të katit përdhes ndodhen musandra, oxhaku dhe një pasqyrë e vjetër. Oxhaku ka dy ornamente florale identike dhe është i ruajtur mirë. Në një

dhomë të këtij kati ndodhet dollapi i vogël i cili mbulohet me kapakë druri që ruhen në formë origjinale. Dy dhoma kanë dollapë, jyklyk për vendosjen e shtrojave dhe tavane. Dollapët janë të vegjël dhe mbulohen me kapakë druri të cilët janë zëvendësuar me dërrasa të reja. Tavanet janë identikë, të shtruar me dërrasa dhe listella të renditura drejtë dhe paralel në mes vete. Zemra është në formë të tetëkëndëshit, pa ornamente. Katër cepat e tavaneve kanë disa motive të vogla të punuara me drugdhendje.

Kati del mbi volumin e katit përdhes në formë konsoli dhe përfundon me një tra të veshur me një dërrasë të zbukuruar me gdhendje të cekët. Në kat janë paradhoma, dhomat me banjo dhe qoshku i cili është pjesa më karakteristike e shtëpisë. Një tavan me rozetën e ornamentuar ndodhet në një dhomë të katit. Qoshku mbahet me shtylla dhe me një pjesë të tij del jashtë volumit të katit. Ai është i hapur dhe i rrethuar në të tria anët me parmakë druri. Në qoshk ndodhet tavani i shtruar me dërrasa dhe listella dekorative. Cepat e tavanit janë të zbukuruar me ornamente të punuara me drugdhendje. Raftet ndodhen në një dhomë të katit përdhes, në paradhomën e katit etj. Disa dhoma janë të shtruara me qilima tradicionale. Përpara nëpër dhoma ka pasë stufa “qymlekllek.”

Shtëpia ka rëndësi arkitektonike dhe historike. Ajo është vënë në mbrojtjen e Ligjit në vitin 1970 /Nr. i vendimit: 1298/70/.

DASMA TRADICIONALE PRIZRENASE

Shpresa Siqeca

Dasma tradicionale prizrenase

Dasmat shqiptare në Prizren ruajnë shumë elemente arkaike të lashtësisë.

Ato i karakterizojnë disa etapa: fejesa, nata e kanagjeqit e vajzës, caktimi i ditës sëdasmës, përgatitjet para dasmës, ceremoniali i dasmës.

Disa doke kryhen që nusja të sjellë mbarësi në familjen e re. Njëra prej tyre është dokja e hedhjes së grurit, elbit, orizit dhe monedhave të argjendta mbi kokën e nuses para se të shkelë pragun e shtëpisë së dhëndrit.

Atë ditë kur vjen nusja në shtëpinë e dhëndrit, ajo e kapërcen pragun e portës me këmbë të djathtë dhe e lye me mjaltë pragun e sipërm të saj, për të sjellë fat, mbarësi dhe lumturi në shtëpinë e re.

Doket tjera kryhen që nusja dhe dhëndrri të mbrohen nga syri i keq dhe të ligat tjera, të kenë një bashkëshortësi të lumtur etj.

Disa veprime magjiko-apotropeike kryhen që nusja të ketë fëmijë, e posaçërisht djem, si trashëgimtarë të familjes. P.sh. nuses, kur arrin në shtëpinë e dhëndrit, ia vënë në prehër një djalë të vogël, të cilin e sjellë tri herë rreth vetes nga e majta në të djathtë. Shtratin e nuses e rregullonte një fëmijë që kishte të gjallë prindërit-për me lindë nusja djem.

Në të kaluarën dhe sot, në doket e dasmës prizrenase vërejmë disa influenza fetare. Te shqiptarët e fesë myslimane kryhet kurorëzimi fetar në xhami. Te shqiptarët e fesë katolike kurorëzimi në kishë ka qenë dhe është edhe sot e kësaj dite ceremoniali më i rëndësishëm i dasmës.

Transformimet në dasmën prizrenase

Në të kaluarën, vajzat dhe djemtë martoheshin në moshën 14 apo 15 vjeçare. Martesat bëheshin kryesisht pa dëshirën e të rinjve. Sot ky raport është ndryshuar në aspektin pozitiv. Martesat kryhen me dëshirën e të rinjve në moshën mbi 18

vjeçare.

Në të kaluarën, në mungesë të hoteleve, dasmat janë bërë nëpër shtëpi. Ka ndodhë që fqiu që kishte shtëpinë më të madhe, ta huazojë atë fqiu i cili bënte dasëm, për atë ditë sa zhvillohej dasma.

Sot dasmat më modeste bëhen në oborre të shtëpive. Dasmorët gostiten me ushqime dhe pije, ndërsa muzika i zbavitë deri në orët e vona të natës. Para portës së jashtme të shtëpisë, nikoqirët e dasmës vënë gjelbërime të cilat i zbukurojnë me dantella.

Sot shumë dasma bëhen në hotele me restorane luksoze. Numri i të ftuarve sillet përafërsisht prej 100 - 300. Dasma fillon zakonisht në mbrëmje dhe përfundon në agim. Ajo përcillet me muzikë popullore dhe zbavitëse, valle, kërcime dhe ahengje. Dasmorët i shoqëron ushqimi, pija dhe ëmbëlsirat. Prej ëmbëlsirave, vlen të përmendet torta e nuses dhe bakllava tradicionale.

Dasma konsiderohet ngjarje më e rëndësishme në jetën e njeriut dhe asaj në Prizren i ipet një rëndësi e posaçme.

Sot një numër i madh i qytetarëve jetojnë në shtetet e jashtme. Fatmirësisht, ata dasmat i bëjnë në Prizren. Falë kësaj, sot numri i bizneseve që është në shërbim të dasmave është në rritje. Të përmendim shitoret e rrobaqepëseve që qepin fustane nusërie dhe fustane tjera solemne, shitoret e stolive, të kozmetikës, këpucëve solemne, shitoret ushqimore etj. Tregtia me Turqinë vazhdon të jetë aktuale rreth furnizimit me mall në shërbim të dasmave. Gjithashtu, të gjitha hotelet që kanë restorane për dasma angazhohen gjatë muajve të verës kur kryhen dasmat. Madje madje, nevojitet të bëhet rezervimi i hoteleve disa muaj para dasmës.

Dasmat prizrenase e shtojnë hijeshinë qytetit, sidomos kur kalojnë kolonat e dasmorëve me makina, flamuj dhe muzikë.

AKTIVITETET E ORGANIZATËS SË PERSONAVE ME DISTROFI MUSKULARE /OPDMK/-QENDRA PRIZREN

Antigona Shestan & Resmija Rahmani

AKTIVITETET PËR NDER TË MUAJIT TETOR- MUAJI I MUNDËSIVE TË BARABARTA

I. EKSPOZITA E PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Më 22.10.2013, në ora 11:00 - 13.00, Organizata e Personave me Distrofi Muskulore e Kosovës /OPDMK/ - qendra në Prizren hapi ekspozitën e fotografive profesionale të personave me nevoja të veçanta (kandidatët që vijnë në kursin zhvillimor).

Ekspozita u hap në Foaje të Kompleksit për Zhvillim dhe Kulturë “Europa”.

Me këtë ekspozitë OPDMK shënoi muajin Tetor - muaji i mundësive të barabarta për persona me nevoja të veçanta. Krahas ekspozitës u prezantua puna konkrete e personave me nevoja të veçanta.

Fjalën e mirëseardhjes e mbajtën Antigona Shestan dhe Resmija Rahmani, Drejtore Ekzekutive dhe themeluese të Organizatës.

Për të përshëndetur ekspozitën ishin ftuar Zyrtarë të cilët në një apo mënyrë tjetër kontribuan në organizimin e ekspozitës. Në këtë mënyrë u ngritë vlera e saj, sepse bëhet fjalë për mundësitë e barabarta dhe të drejtat e personave me nevoja të veçanta. Folën: Çemailj Kurtishi dhe Ruzhdi Rexha Nënkyetarë të Kuvendit Komunal, Sinan Gashi - Përfaqësues i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Qendra Regjionale, Prizren dhe Marem Rahte - Përfaqësues i Qendrës Kulturore “Yunus Emre”, Prizren. Hapjen solemne të ekspozitës e bëri Yllka Berisha, anëtare e Shoqatës së Verbërve dhe të Atyre me të Pamë të Dobësuar.

Ekspozita u shoqërua me koktej. Ajo u përkrahë nga Qendra Rajonale e OSBE-së në Prizren dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit.

II. AKTIVITETI REKREATIVO- SPORTIV “MAKE A DIFFERENCE”

Për nder të Muajit tetor- Muaji i mundësive të barabarta, Organizata e Personave me Distrofi Muskulore e Kosovës (OPDMK) qendra në Prizren organizoi aktivitetin rekreativ-sportiv me moton “Make a difference.” Aktiviteti u mbajtë me 14.XII.2013 në Gjymnazin Loyola në Prizren.

Qëllimi i aktivitetit ishte që të ipen mundësitë e barabarta për persona me nevoja të veçanta që të jenë pjesë gjithëpërfshirëse e shoqërisë.

Gjatë aktivitetit u organizuan gara dhe lojëra të ndryshme sportive: gara me karroca elektrike, stili (Zig Zag); gara me karroca të zakonshme në mes të ushtarëve dhe personave me nevoja të veçanta; gara në shah, pikado, ping-pong, alpinizëm dhe loja miqësore e basketbollit. Pas kryerjes së garave, u ndanë mirënjohje për më të mirët.



Ky aktivitet ishte pjesë e Projektit të financuar nga OJQ “Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës” /RrGGK/. Menaxhere e Projektit ishte Antigona Shestan.

AKTIVITETE TË TJERA

1. Kursi i kompjuterëve për persona me nevoja të veçanta; Nga ana e Kuvendit Komunal është dhënë në shfrytëzim lokali në Qendrën për Art dhe Zhvillim “Europa”. Donator i Projektit: Zyra Ndërlidhëse e Sllovakisë në Kosovë. 2. Kursi i fotografisë për persona me nevoja të veçanta; 3. Tre persona ndoqën Ligjerata të Biznesit. Prej tyre, Resmija Rahmani përfitoi grantin për Ndërmarrësi nga Ministria e Kosovës për Kulturë, Rini dhe Sporte.

AKTIVITETET GJATË MUAJIT TETOR MUAJI I MUNDËSIVE TË BARABARTA

RADIO EMISIONE PËR NDER TË MUAJIT TETOR - MUAJI I MUNDËSIVE TË BARABARTA

Për nder të muajit Tetor - muaji i mundësive të barabarta, Kuvendi Komunal i Prizrenit - Zyra e NJDNJ dhe e Barazisë Gjinore organizoi 2 Radio emisione. Në të dy emisionet morën pjesë personat me aftësi të kufizuara, të cilët gjatë këtij muaji u punësuan përkohësisht nëpër institucione shtetërore apo private të qytetit, si dhe zyrtarët që punojnë për personat me aftësi të kufizuara.

Emisioni i parë u emitua në fillim të muajit Tetor dhe shpalosi aktivitetet që planifikohen të ndërmerren gjatë këtij muaji. Morën pjesë: Miradije Buçaj dhe Valmira Berisha, Shoqata Ndërkomunale e të Verbërve dhe atyre me të Pamë të Dobësuar”, Drita Vukshinaj, OJQ “Femra për Femrat me Aftësi të Kufizuara” dhe një përfaqësues i Komitetit për persona me aftësi të kufizuara.

Emisioni i dytë u emitua në fund të muajit tetor dhe shpalosi aktivitetet e kryera dhe rezultatet e arritura në muajin Tetor. Morën pjesë: Drita Vukshinaj, OJQ “Femra për Femrat me Aftësi të Kufizuara”, Zijada Xhaferi, OJQ “Handikos” - Qendra e Rehabilitimit e Bazuar në Bashkësi, Drita Çitaku “Qendra Burimore për Fëmijët /Personat/ me Sindromën Doën /DKS/ - Qendra Prizren, Elsim Murati, person me shikim të dobësuar dhe Yllka Berisha, Shoqata Ndërkomunale e të Verbërve dhe atyre me të Pamë të Dobësuar.



Nga e majta në të djathtë: Drita Vukshinaj /OJQ “Femra për Femrat me Aftësi të Kufizuara”/ dhe Zijada Xhaferi, OJQ “Handikos,” Radio emisioni kushtuar muajit Tetor Muaji i mundësive të barabarta

PUNËSIMI I PËRKOHSHËM I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Gjatë muajit Tetor - muaji i mundësive të barabarta, 21 persona me aftësi të kufizuara u punësuan përkohësisht në Institucione shtetërore, Organizata të huaja dhe ndërmarrje private: 1.Kuvendi Komunal /Drejtoritë për Arsim dhe Financa, Zyra e Avokaturës, Zyra e NJDNJ dhe e Barazisë Gjinore dhe Zyra e Ofiqarisë/;

2. Qendra Rajonale e OSBE-së, Prizren; 3. Spitali Rajonal, Prizren; 4. Qendra tregate “Abi Center”; 5.Qendra tregate “Ben-af”; 6. N.P.T.SH. “Limit”; 7. N.P.N. “ALFA-ING”; 8.Agjensioni turistik “Veseli tours”. Punuan 3, 5 ose 7 ditë.

Qëllimi kryesor i Projektit është punësimi i përkohshëm i personave me aftësi të kufizuara që ata të ndihen të barabartë, të fitojnë përvojë pune dhe përfitime materiale për veten dhe familjen.

TRAINIMI DHE GARA NË BILIARD PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Për nder të muajit Tetor - muaji i mundësive të barabarta, Kuvendi Komunal i Prizrenit, Qendra Rajonale e OSBE - së në Prizren dhe Klubi i Biliardos “Prizreni 1890” organizuan trainim dhe gara në biliard për persona me aftësi të kufizuara. Manifestimi u organizua më 17.X.2013 në Stacionin e karburantit “AS PETROL” prej orës 12:30 - 15:00. Fjalën e hapjes e mbajtën përfaqësuesit e Kuvendit Komunal të Prizrenit, Qendrës Rajonale të OSBE - së në Prizren dhe Klubit të Biliardos “Prizreni 1890.”

Gjatë manifestimit, Klubi mbajti mësim për rregullat e lojës së biliardos dhe organizoi gara në biliard për persona me aftësi të kufizuara.

Në këtë manifestim morën pjesë: OJQ K.B.K. “Marsi” /Klubi i Basketit në Karroca/, OJQ “Handikos” - Qendra e Rehabilitimit e Bazuar në Bashkësi, Organizata e Personave me Distrofi Muskulare të Kosovës - Qendra Prizren /O.P.D.M.K/, Qendra Burimore për Fëmijët /Personat/ me sindromën Down, Shoqata e të Shurdhërve etj. Bashkëpunimi i Klubit të Biliardos “Prizreni 1890” do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme.

RADIO EMISIONI KUSHTUAR MUAJIT TETOR- MUAJIT TË LUFTËS KUNDËR KANCERIT TË GJIRIT

Shpresa Uka

Radio emisioni kushtuar Muajit tetor- Muajit të Luftës kundër Kancerit të Gjirit, u emitua në Radio Heliks me dt.14. X. 2014, ora 14,00-15.00. Në emision morën pjesë: Dr. Shpresa Llukaj Goçaj, specialiste e radiologjisë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prizren dhe Mybexhel Zhuri, Koordinatore e NJDNJK-së dhe Zyrtare për Barazi Gjinore pranë Kuvendit Komunal, Prizren.

Cili është qëllimi i fushatave senzibilizuese në luftë kundër kancerit të gjirit?

Dr. Shpresa Llukaj Goçaj: Muaji tetor është muaji i proklamuar për luftimin e kancerit të gjirit. Fushata ka për qëllim vetëdijësimin e popullatës për këtë sëmundje, ndërsa shiriti roze simbolizon mbështetjen e fushatës. Vetëdijësimi ndikon në marrjen e masave për zbulimin dhe diagnostifikimin me kohë të sëmundjes.

Kanceri i gjirit është sëmundje malinje që e atakon femrat më shumë por edhe meshkujt, duke e shtuar rrezikshmërinë për vdekjen. Me shtimin e moshës, shtohet edhe rrezikshmëria nga sëmundja. Faktorët që ndikojnë në paraqitjen e sëmundjes janë: 1) Faktori gjenetik; 2) Faktori hormonal /kur femra i nënshtrohet ndërrimeve hormonale/; 3) Ambienti dhe mënyra e jetës etj; Te ne fatkeqësisht sëmundja është në rritje, edhe pse nuk kemi statistika të plota.

A zbulohet lehtë sëmundja?

Dr. Shpresa Llukaj Goçaj: Fatkeqësisht jo, për këtë arsye apelojmë në vizitat e rregullta, me qëllim të zbulimit të hershëm të sëmundjes, sepse gjasat për shërim janë shumë më të mëdha.

Cila është këshilla e parë për femra?

Dr. Shpresa Llukaj Goçaj: Do të këshilloj që secila femër të kryej vetëkontrollin e gjinjve. Gjatë ligjeratave gratë njoftohen për mënyrën e vetëekzaminimit të gjirit. Një numër i femrave hezitojnë dhe frikësohen të bëjnë vetëekzaminimin.

Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prizren kemi aparatet e ultrazërit dhe të mamografisë. Këtë vjet kam propozuar që muajin tetor të shpallim muaj human dhe ekzaminimi me ultrazë dhe mamografinë të kryejmë falas. Me përkrahjen e Drejtorisë së

Shëndetësisë, çdo vjet në muajin tetor ekzaminimi me ultrazë si dhe mamografia do të vazhdojnë të jenë falas. Në muajt e tjerë këto shërbime do të paguhen me një shumë simbolike. Për rastet sociale, pensionistet, familjet e dëshmorëve dhe të invalidëve të luftës ekzaminimet janë falas. Te ne mungon një program nacional dhe kjo shkakton mospërfshirjen e shumë moshave në vizita. Unë mendoj se duhet të aplikohen vizitat sistematike të femrave. Besoj se nismat tona do të përkrahen nga Institucionet më të larta shtetërore. Duhet të kemi përkrahje në vazhdimësi, jo vetëm një muaj, por gjatë tërë vitit.

Sa jeni të kënaqur me senzibilizimin e popullatës?

Dr. Shpresa Llukaj Goçaj: Është me rëndësi që dita ditës femrat e qytetit dhe të zonave rurale po bëhen më të rregullta në vizita te mjeku.

Sa jeni të kënaqur me fushatat sensibilizuese me anë të mediave?

Dr. Shpresa Llukaj Goçaj: Mundë të bëhet edhe më tepër në këtë drejtim. Sidomos me anë të gazetave duhet të shpërndahen më shumë informacione për sëmundjen.

A po vetëdijësohemi si shoqëri për shëndetin e grave?

Dr. Shpresa Llukaj Goçaj: Po, jeta ka shumë vlera dhe shëndeti ynë është mbi të gjitha. Femrat janë shtylla e familjes, ato janë nëna dhe bashkëshorte, prandaj duhet të kushtohet një vemendje e veçantë shëndetit të tyre.

Këshillat për dëgjueset e Radio Helix?

Dr. Shpresa Llukaj Goçaj: Për të gjitha femrat që na dëgjojnë në këtë moment do të porosis që të lajmërohen për vizitë te mjeku, pavarësisht a kanë apo jo ankesa apo probleme.

RADIO EMISIONI KUSHTUAR MUAJIT TETOR- MUAJIT TË LUFTËS KUNDËR KANCERIT TË GJIRIT

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Prizren posedon aparat të ultrazërit me elastografi dhe me aparatën e Mamografisë si dhe personel të specializuar në këtë lëmi. Gjatë muajit Tetor kjo qendër ofron shërbime falas për qytetarët e Komunës së Prizrenit.

Sa keni arritur të sensibilizoni femrën për vizita te mjeku?

Mybexhel Zhuri: Si çdo vjet, edhe këtë vjet Kuvendi Komunal organizon fushatën me qëllim të sensibilizimit dhe të zbulimit të hershëm të sëmundjes. Kemi bërë sensibilizimin e popullatës me mbajtjen e ligjeratave dhe botimin e fletushkave, por nuk kemi tregues se sa është arritë ky sensibilizim. Ne mundohemi që çdo vjet të përfshijmë rajone të ndryshme, sidomos zonat rurale për të ofruar informacione për sëmundjen.

Sa kanë qenë të gatshme Insitucionet të ndihmojnë fushatën?

Mybexhel Zhuri: Gjithmonë kanë qenë të gatshëm, sidomos Drejtoria e Shëndetësisë pranë Kuvendit Komunal, Prizren.

Ku do të zhvillojë këtë vjet fushatat sensibilizuese?

Mybexhel Zhuri: Fushatat do të zhvillojmë në dy fshatra: Lubinje e Ulët dhe në Romajë. Në këto fshatra do të mbahen ligjerata, shpërndahen fletushka dhe fjonge roze.

Ka shumë nisma të OJQ-ve rreth kësaj problematike, sa po dëgjohet zëri i tyre?

Mybexhel Zhuri: Ne mbajmë kontakte të rregullta me OJQ-të e grave, sepse ato janë në terren dhe i evidentojnë nevojat e komunitetit.

Sa po e arrin efektin fushata sensibilizuese?

Mybexhel Zhuri: Tregues i suksesit janë numri i grave që paraqiten për vizitë te mjeku. Me vet faktin që ne shkojmë dikund, gratë na dëgjojnë, informohen dhe pyesin mjekun.

Kemi menduar që në vitin e ardhshëm të fillojmë me fushata që nga shkurti. Kështu do të përfshihet tërë territori i Prizrenit. Sadopak vetëdijësimi i grave është ngritur. Kemi një

OJQ që është e interesuar të zhvillojë këtë Projekt në kuadër të aktiviteteve të veta.

A mendoni se vizita e femrave te mjeku duhet të jetë e detyrueshme?

Mybexhel Zhuri: Po, sepse po jetojmë një jetë dinamike, prandaj kishte me qenë e dobishme që vizitat te mjeku të jenë të detyrueshme. Unë kam insistuar që të bëhet kontrollimi sistematik i grave. P.sh. në vendet e punës qoftë shtetërore apo private, punëdhënsi të kërkojë nga gratë të vizitohen te mjeku.

Me një fjalë duhet të shtojmë vizitat te mjeku për arritjen e shëndetit më të mirë të popullatës.

Çfarë materiale promovuese keni botuar këtë vjet?

Në vend të broshurave sensibilizuese, këtë vjet Kuvendi Komunal botoi Kufizues për libra me moton "Shtojë kujdesin për shëndetin tënd." Në tekst ipen informacione shumë të dobishme për sëmundjen e kancerit të gjirit.

Shpresoj se lexueset e librave do t'i hedhin një sy tekstit të Kufizuesit. Gjithashtu kemi shpërndarë fjonge roze, në shenjë të solidaritetit me gratë e prekura nga kjo sëmundje.



MUAJI TETOR

MUAJI I LUFTËS KUNDËR KANCERIT TË GJIRIT

SHTOJE KUJDESIN PËR SHËNDETIN TËND

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Prizren posedon aparat të ultrazërit me elastografi dhe me aparatën e Mamografisë si dhe personel të specializuar në këtë lëmi. Gjatë muajit tetor kjo qendër ofron shërbimë falas për qytetarët e Komunës së Prizrenit.

Kanceri në gji nëse diagnostifikohet me kohë, mund të kurohet dhe vazhdimi i jetës normale nuk është aspak i vështirë.

Me vet-kontrollimin e rregullt të gjirit, një herë në muaj, ju mund të vëreni ndryshimet, të dalloni ndonjë kokërr, dhe në këto raste konsultohuni me mjekun.

Simptomat: Ndër simptomat më kryesore janë: ndryshimi i gjirit, i madhësisë ose i formës, tërheqja e lëkurës ose plagë të ndryshme, sekrecione nga gjiri si dhe gjëndra të ndryshme në zonë e sqetullave.

Këshillohet që vet-kontrollimi të bëhet një herë në muaj, vizita klinike te specialist një herë në gjashtë muaj, kurse mamografia çdo dy vjet /varësisht nga rasti/.

Mybexhel Zhuri



Mybexhel Zhuri dhe gratë e Lubinjes së Poshtme, 21.X.2013.

LIGJERATAT SENZIBILIZUESE NË FSHATRA

Për nder të Muajit Tetor - muaji i Luftës kundër Kancerit të Gjirit, në fshatrat Lubinje e Poshtme, Manastircë, Romajë dhe Gjonaj u mbajtën ligjerata për senzibilizimin e popullatës rurale rreth rrezikut nga kanceri i gjirit.

Ligjeratat i mbajti Dr. Shpresa Llukaj Goçaj, specialiste e Radiologjisë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prizren. Gjatë ligjeratave u shpërndanë Kufizuesit për libra me moton “Shtojë kujdesin për shëndetin tënd.” Gjithashtu u shpërndanë fjonga roze, në shenjë solidariteti me gratë e sëmura nga kanceri i gjirit.

Në Lubinje të Poshtme ligjeratat u mbajtën më 21.X.2013. Në ligjerata morën pjesë rreth 25 gra të këtij fshati. Ligjeratat u mbajtën në lokal të shkollës dhe zgjatën rreth 1 orë. Ato u shoqëruan me pyetje dhe diskutime.

Treguesit e suksesit: Është rritë numri i grave nga këto rajone rurale që paraqiten në vizita në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prizren.

Ligjeratat dhe materialet promovuese i finansuan: Kuvendi Komunal i Prizrenit -Zyra e NJDNJ dhe e Barazisë Gjinore dhe Qendra Rajonale e OSBE-së, Prizren.

Shpresa Siqeca



Dr. Shpresa Llukaj -Goçaj, specialiste e Radiologjisë Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, Prizren

FUSHATA MBARËBOTËRORE KUNDËR DHUNËS NDAJ GRUAS

Në kuadër të Fushatës Mbarëbotërore kundër Dhunës ndaj Gruas dhe Fëmijëve /25.XI-10.XII.2013/, Kuvendi Komunal /Zyra e NJDNJ dhe e Barazisë Gjinore/ në bashkëpunim me Zyren Rajonale të OSBE-së në Prizren organizuan Fushata Senzibilizuese /Ligjerata dhe Tryezë të Rrumbullakët/

25 Nëntor-10 Dhjetor FUSHATË MBARËBOTËRORE KUNDËR DHUNËS NDAJ GRUAS DHE FËMIJËVE

Nga respektimi dhe vlerësimi i rolit të gruas varet dhe shkalla e zhvillimit të shoqërisë.

Jepni kontributin e juaj dhe krijoni mjedis më të sigurt dhe më të përshtatshëm për të gjithë.

Nëse jeni viktimave e dhunës dhe ju duhet ndihma, kontaktoni:

Policia	922
Qendra Për Punë Sociale	029223-451 044802-622
Mbrojtësi i Viktimave	044310-468

Dhuna është dobësi

- Dhuna nuk është zgjidhje e problemit;
- Dhuna është shkelje e drejtave të njeriut;
- Dhuna i lëndon të gjithë, jo vetëm gratë;
- Dhuna shqetëson fëmijët;
- Dhuna çrregullon marrëdhëniet familjare dhe shoqërore;
- Ndryshoni raportet ndërnjerëzore;
- Keni durim, ndëgjoni njëri tjetrin;
- Mos i impononi interesat personale, krijoni mirëkuptim;
- Respektoni liritë dhe vullnetin e gruas;
- Luftoni fenomenin e dhunës ndaj gruas;

Mybexhel Zhuri



Ligjeratat senzibilizuese me nxënës të shkollave të mesme, Prizren, 2.XII.2013

FUSHATAT SENZIBILIZUESE KUNDËR DHUNËS NDAJ GRUAS DHE FËMIJËVE

Me datën 2.XII.2013 u mbajtë Ligjerata me nxënës të shkollave të mesme. Morën pjesë nxënësit e Gjinnazit “Gjon Buzuku” dhe të Shkollës së Mesme të Lartë Teknike “11 Marsi”. Ligjerata u mbajtë në sallën e Kuvendit Komunal, Prizren. Ligjeratat i mbajti Kumrije Krasniqi, Zyrtare e Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale. Nxënësve u shpërndanë broshura dhe kufizues për libra për të promovuar parandalimin e dhunës ndaj gruas. Gjithashtu u shpërndanë fjonge të bardha, në shenjë të luftës kundër dhunës ndaj gruas.

Me datën 5. XII.2013, u mbajtë Ligjerata me nxënës të shkollave fillore të Prizrenit.

Me datën 9.XII.2013 u mbajtë Ligjerata me persona me aftësi të kufizuara. Ligjerata u mbajtë në ndërtesën e OJQ-së “Handi-Basketi.” Ligjeratat i mbajti Mybexhel Zhuri, Koordinatore e NJDNJ dhe e Barazisë Gjinore pranë Kuvendit Komunal, Prizren.

Me datën 6.XII.2013, në sallën e Kuvendit Komunal u mbajtë Tryeza e Rrumbullakët me temën “Dhuna në familje” e cila u fokusua në mënyrë të veçantë te dhuna ndaj gruas. Morën pjesë përfaqësues të Institucioneve qeveritare dhe joqeveritare që mirren me çështjen e dhunës në familje. Qëllimi i Tryesës ishte ngritja e vetëdijes për situatën aktuale dhe niveli i bashkëpunimit institucional.


Dhunës në familje iu kushtuan 2 Radio emisione.

Emisioni i parë u emitua me datën 12.XI.2013. Në emision morën pjesë: Mybexhel Zhuri, Koordinatore e NJDNJ dhe Zyrtare për Barazi Gjinore në Kuvendin Komunal të Prizrenit dhe Jubilea Kabashi, Drejtoreshë Ekzekutive e Qendrës për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve, Prizren. Emisioni u emitua në “Radio-Helix”. Emisioni i dytë u emitua në “Radio-Prizren.”

Shpresa Siqeca

MODEL I ENDUR NË VEK

*Fragment përparëseje e endur me ngjyra të ndryshme.
Modeli është nxjerrë nga bordura e një përparëseje të grave
të rajonit të Hasit të Prizrenit.*




Një katror-një gojë e endur në vek

- 1 Ngjyrë e gjelbër e mbyllët;**
- 2 Ngjyrë e gjelbër e çelët;**
- 3 Ngjyrë e bardhë;**
- 4 Ngjyrë e zezë**
- 5 Ngjyrë roze;**



Nga e majta në të djathtë: Dr. Laura Guguli, Gentijana Dërdovski dhe Vjosa Curri, Qendra Për Këshillim dhe Përkrahje të Gruas “Dora-Dorës”, Prizren



Model i endur në vek, Rajoni i Hasit të Prizrenit



Drita Vukshinaj, “Femra për Femrat me Aftësi të Kufizuara”



Krenare Hajredini, Shoqata e Femrave të Shurdhër, Prizren



Fetije Mehmeti, OJQ “Gruaja bashkëkohore”, Prizren



Sara Sahiti, OJQ “Sara” Prizren

